



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT BASHKIAK DEVOLL

Tel&Fax : 081123330

e-mail:spitalidevoll@shendetsia.gov.al

Nr. 577 prot

Bilisht, më 16/ 09 /2021

LËNDA: Kthim përgjigje

DREJTUAR: "RES PUBLICA"

Bulevardi Gjergj Fishta Nd24 H3 Ap7

Tirane, Shqiperi

Në përgjigje të shkresës tuaj drejtuar Spitalit Bashkiak Devoll që mban nr 1484/1prot te datë 14.09.2021 po ju dërgoj informacion si më poshtë:

Spitali Bashkiak Devoll nuk ka qënë pjesë e skenareve për tratimin e pacientëve të prekur nga COVID-19, nisur nga kjo në spitalin tonë është kryer vetëm triazhimi i rasteve COVID -19 për 680 pacientë.

Në kuadër të investimeve, gjatë periudhës së pandemisë janë shtuar linjat funksionale të burimeve të oksigjenit duke u plotësuar në 100%. Për furnizimin e oksigjenit medikal spitali ynë ka lidhur kontratë me kompaninë Messer Albagaz Shpk me nr 313prot date 08.06.2020 per nje sasi prej 1800 litra oksigjen I gaztë mjekësor sasi kjo e prokuruar nga organi qendror blerës për vitin 2020-2021.

Për nevoja spitalore dhe I gjendur ne kushtet emergjences Spitali Bashkiak Devoll ka shtuar kontratën e oksigjenit me të njëjtin operator ekonomik dhe me cmim të pa ndryshuar për nje sasi prej 2000 litra oksigjen I gaztë mjeksor që do të meret sipas nevojave që ka spitali për këtë medikament.

Faleminderit





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMIT SPITALOR DEVOLL

313 prot

Devoll më 8/06/2020

KONTRATË FURNIZIMI

Nënshkruar sot më 28/06/2020 në Devoll.

Përfunduar ndërmjet palve.

Drejtoria e shërbimit spitalor Devoll e quajtur më poshtë BLERËS, përfaqësuar nga Drejtori
Z. ERJOL DANGLLI

dhe Messer Albagaz Shpk me NIPT: K78317002F me adresë: Autostrada Tirane – Durres Km
4.5 Tirane, përfaqësuar nga Administratori Vldimir Vladimirov, quajtur Shitesi me poshtë

Kjo kontratë lidhet në bazë të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik në procedurën e
prokurimit me Ref-Up Nr 123 date 02.2.2018 procedure e Hapur zhvilluar nga Ministria e
Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale ne cilesine e organit qendror blerës me objekt "Oksigjen i
gaztë mjekësor".

Baza Ligjore: Kodi Civil, nenet 772 e vijues, Ligji Nr.9643 dstr 20.11.2006 "Per Prokurimin
Publik" i ndryshuar ,si dhe Vendimi Nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te
prokurimit"

Neni I: Objekti i Kontrates

Objekti i kontrates eshte furnizimi me mall "Oksigjen i gazte mjekesor" per Spitalin Devoll.
Sasia

Nr	Emërtimi	Njësia	sasia	Cmimi/lek	Vlera/ Lek
1	Oksigjen i gazte mjekesor	litra	1800	34.56	62208



total e kontrates eshte 62208 (gjashtedhjetë e dy mijë e dyqind e tetë) leke pa tvsh.
Mungesa do te kryhen ne baze te fatures latimore te cilen Kontraktuesi do te paraqese per cdo dorëzim malli.

Malli do te levrohet nga kontraktuesi prane autoritetit kontraktor me cmimin e percaktuar ne oferten fituese sipas procedures se prokuruar. Ne cmim jane te perfshira te gjitha detyrimet fiskale dhe shpenzimet e transportit deri ne destinacion.

Neni II. Afati i levrimit.

Afati i levrimit te mallit do te jete me lidhjen e kontrates deri ne daten 31/12/2020.
Autoriteti kontraktor per levrimin e mallit duhet te njoftoje shitesin cdo fund muaji perpara furnizimit te muajit pasardhes.

Neni III. Dokumentat shoqeruese te mallit.

Malli i dorëzuar do të shoqërohet me faturë shitjes.
Autoriteti kontraktor dhe kontraktuesi do të mbajnë një procesverbal dorëzimi malli ku do të pasqyrohet sasia e dorëzuar dhe gjëndja e bombolave së bashku me numrin serial të tyre.
Bombolat pas përdorimit dhe zbrazjes duhet t'i rikthehen kontraktusit në të njëjtën gjëndje që janë dorëzuar.

Në rastin kur kontraktuesi kostaton dëmtim të bombolave gjatë dorëzimit nga ana e autoritetit kontraktor, atij i lind e drejta të kërkojë zhdëmtimin e plotë të dëmit që i është shkaktuar bombolave sipas Nenit 5 të kësaj kontrate.

Neni IV. Cilesia e Mallit


Mallrat do te kolaudohen nga autoriteti kontraktor prane institucionit te vet nga personat e ngarkuar per kete qellim ne prani te perfaqsesit te kontraktusit, ne rast te mungesave apo demtimeve do te njoftohet menjehere me shkrim kontraktuesi.

Kur mallrat nuk jane sipas cilesise se kerkuar nuk do te pranohen nga Autoriteti Kontraktor dhe per reklamimin do njoftohet Kontraktuesi i cili duhet te zvendesoje menjehere mallrat qe rezultojne me mungesa apo jo me cilesin e kerkuar.

Mallrat e kerkuar do te plotsojne specifikimet e meposhtme:

1. perbersit te oksigjenit te gazte mjekesor do te jene te percaktuara sipas DST

Presioni i mbushjes se bombolave te jete 125 bar.
Sasia e Oksigjenit ne bombol te jete 40 50 litra per presionin 125 bar.
Amballazhimi te behet me bombol 40 dhe 50 litra.
Bombola te kete shenjen dalluse "Per perdorim spitalor" (O2)



...i mallit deri ne destinacion eshte detyrim i kontraktusit ndersa shkarkimi i mallit
...i autoritetit kontraktor.
...i humbje te bomboles ne pronesi te kontraktusit ose demtim te saj autoriteti kontraktor
...i detyruar te paguaj kontraktusin per demin e shkaktuar si me poshte:

- a. Ne rastin e humbjes ose demtimit te plote te bomboles qe e ben te pamundur perdorimin e saj autoriteti kontraktor eshte i detyruar te paguaj vleren e blerjes te bomboles e cila eshte 20000 (njezet mije) Lek.
- b. Ne rastin e demtimit te vintilit te bomboles autoriteti kontraktor eshte i detyruar te paguaj vleren e riparimit per demtimin e vintilit e cila eshte 4600 (kater mije e gjashteqind) Lek

Kontraktusi nuk mban pergjegjesi per demet qe mund t'i shkaktohet autoritetit kontraktor nga mosrespektimi i rregullave perkatese ne lidhje me perdorimin e mallit dhe amballazhit te tij.

Neni V. Pagesat

- 1- Pagesa per furnizimin do te kryhet, pas marrjes se mallit me fature tatimore nga dhe dhe do te paguhet per Messer Albagas Shpk , në nr e llogarise bankare 0004293521 prane Raiffaisen Bank. (dhe IBAN-in AL78202112880000000004293521) monedha e pagesës do të jetë Lek. . per Shoqerine "MESSER ALBAGAZ"SH.P.K. (sipas Kontrates se bashkepunimit Nr 360 Rep, Nr 88/2 Kol, date 12.03.2020)

Neni VI. Sigurimi i kontrates.

Sigurimi i kontrates ne shumen prej 10% te vleres se Kontrates _____ leke. duhet te ofrohet nga Kontraktusi per te sguruar realizimin e detyrimeve te tij sipas kontrates. Sigurimi i kontrates do ti leshohet ose kthehet,menjehere Kontraktuesit brenda 10 diteve nga perfundimi i kontrates.

Neni IX. Zgjidhja e menjehershme e kontrates.


Secila pale ka te drejte te zgjidh kontraten nese pala tjeter nuk i permbush detyrimet e marra ne kete kontrate duke njoftuar me shkrim 45 dite perpara.Kontrata nuk do te zgjidhet ne menyre te njeanshme kur nuk ka baze ligjore dhe arsye te justifikuar per tu bere ky veprim.

Kontraktuesi ose Autoriteti kontraktor mund te zgjidhin kontraten duke njoftuar parapraktikisht me shkrim nese pala tjeter shkakton shkelje themelore te kesaj kontrate sic mund te jene:

1. Kontraktuesi vonon me shume se njehere furnizimin sipas afatit te perezaktuar ne kontrate me perjashtim te rasteve kur vonesa shkaktohet nga nje fuqi madhore si : permbajtje ,zjarr,etj.
2. Autoriteti kontraktor nuk kryen ne kohe pagesen e mallit ose nuk paguan per demet e shkaktuar kontraktuesit te parashikuar ne kete kontrate.

Per moszbatimin e kontrates nga te dy palet , secila pale ka te drejte te zgjidh kontraten.

Autoriteti Kontraktor dhe kontraktuesi duhet te bejne te gjitha perpjektet per te zgjidhur me mirkuptim te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me kete kontrate.Nese palet



nuk bien dakort per zgjidhjet e ofruara ato do ti drejtohen Gjykares Kompetente per
e mosmarveshjes se tyre.

per Kontraktuesin

Vladimir Vladimirov



TIRANE

Adresa Tirane

Tel: +355 68 20 90 905

NIPT: K78317002f

Per Autoritetin Kontraktor

Erjol Danglli



Adresa "Bilisht Devoll"

Tel: +355 811 23 330

NIPT: L06508691B

